



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR

Nr. 7659/1

Shkodër, më 19.06.2020

Lënda: Përgjigje kërkesë për informacion

Email: _____

Në përgjigje të kërkesës tuaj drejtuar Bashkisë Shkodër me e.mail me datë 16.07.2020 në të cilën bazuar në ligjin nr.119/2014, “Për të Drejten e Informimit” kërkonti informacion për ngritjen e Zyrës për Mbrojtjen e Konsumatorit, ju bëjmë me dije se:

Edhe pse siç ju citoni, ngritja e Zyrës së Mbrojtjes së Konsumatorit pranë bashkive është parashikuar në Strategjinë Ndërsektoriale për Pushtetin Vendor, Bashkia Shkodër nuk ka një zyrë të tillë.

Bazuar në ligj nr.139/2015 “Për vetëqverisjen vendore”, mbrojtja e konsumatorit nuk është funksion i drejtëpërdrejtë i qeverisjes vendore.

Por, Bashkia Shkodër me anë të Drejtorisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Trajtimit të AMTP-ve bazuar në Ligj nr.10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, mbrojtjen e konsumatorit e realizon duke kryer:

- kontrollin e thertoreve apo njërive të therjes të përcaktuara dhe të miratuara
- trajtimin e kafshëve endacake e të braktisura
- bashkëpunimin me strukturat e shërbimit veterinar rajonal për zbatimin e masave profilaktike, në kufizimin dhe çrrenjosjen e sëmundjeve infektive tek kafshët.

Shërbimi Veterinar i Bashkisë Shkodër, në zbatim të detyrave të tij funksionale ka ushtruar monitorim dhe kontrole të vazhdueshme në tregjet e gjësë së gjallë dhe thertoreve. Janë kontrolluar, vulosur dhe shoqëruar me çertifikatë shëndetësore veterinare 1354 (Janar-Maj 2020) therje në thertore. Gjithashtu ka pasur bashkëpunim me Inspektoriatin Shtetëror Veterinar Rajonal për kontrollin e periodik në tregjet e gjësë së gjallë.

Në vijim të punës së saj, Drejtoria e Bujqësisë, në bashkëpunim me strukturat e Inspektoratit Shtetëror Veterinar Rajonal ka bërë të mundur groposjen e kafshëve të ngordhura në mënyrë periodike sipas rasteve të paraqitura.

Vazhdon trajtimi i problematikës së qenve endacake në territorin e Bashkisë Shkodër ku në bashkëpunim me shoqatat e mbrojtjes së kafshëve vijon trajtimin e qenve endacakë. Këtu përfshihet kapja, vaksinimi, sterilizimi, Matrikullimi, dehelmetizimi si dhe trajtime të ndryshme antiparazitar të këtyre kafshëve. Për vitin 2020 është lidhur kontrata e shërbimit Nr. 3518 Prot. date 15.04.2020 me “ Best Friend” (Putrat) sh.p.k. per kapjen dhe trajtimin e 214 qenve të rrugës.

Në faqen e internetit të bashkisë Shkodër, mund të gjeni informacion tek buxheti 2020, tek programi 04220 “Shërbimet bujqësore, inspektimi, siguria ushqimore dhe mbrojtja e konsumatorëve, ose duke klikuar në http://www.bashkiashkoder.gov.al/web/sherbimet_bujqesore_inspektimi_ushqimi_dhe_mbrojtja_e_konsumatoreve_2878_3155.pdf

Mbetemi të hapur për çdo bashkëpunim me ju.

Me respekt

Dajana Cico

Koordinatorë për të Drejtën për Informim

Bashkia Shkoder